



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 843/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Laziç, dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fahredin Hajda, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Fahredin Hajda, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.11.2013, nga Fahredin Hajda për subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, në të cilën pretendohet se në vendvotime ekziston mospërputhje e fletëve të votimit me procesverbalet e komisionerëve, prandaj votuesit e mi janë në regjistër që dëshmojnë votën që e kanë dhënë. Nga pretendimet ankimore të lartëcekura ia ka bashkangjitur një shkresë të datës 08.11.2013 drejtuar Komisionit Komunal Zgjedhor KKZ në Rahovec, ku theksohet se, kërkoi rinumërimin e votave të listave të votuara për Kandidatë Komunalë në Rahovec. Për më tepër ka shtuar se, votat e numëruara dhe procesverbalet e vërtetuara nuk i dëshmojnë votimet e pretenduara, prandaj ekzistojnë dyshime të bazuara se votimet janë numëruar dhe nuk janë pasqyruar realishtë. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur fletëlistën e votuesve në qendrat e votimit QV.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrës ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 843/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.